



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.04.2021

Nr: 216

**URDHËR**

**PËR**

**DISIPLINIMIN E PROCESIT TË NUMËRIMIT TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR  
KANDIDATËT E LISTAVE SHUMEMËRORE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE**

Në mbështetje të pikës 1, shkronja “b”, dhe pikës 2, të nenit 19, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të vendimit nr. 14 datë 10.04.2021, të Komisionit Rregullator, “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, rradhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votive dhe nxjerrjes së rezultatit të Zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend”, duke marrë shkas nga problematikat e hasura përgjatë procesit të numërimit të votive të kandidatëve të listave shumemërore të subjekteve zgjedhore

**URDHËROJ:**

1. Komisionet e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe Grupet e Numërimit të Votave në procesin e vlerësimit të votave për kandidatët e listës shumemërore të subjektit zgjedhor veprojnë në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të vendimit nr. 14, datë 10.4.2021 të Komisionit Rregullator “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend”.
2. Grupet e numërimit të votave (GNV-të) nuk mund të rivlerësojnë votat e pasqyruara në tabelën përmbledhëse të rezultateve për partitë, koalicionet, kandidatët e pavarur (subjekteve zgjedhore) të ZAZ-së dhe nuk mund të konsiderojnë vota të pavlefshme për subjektet zgjedhore votat të cilat nuk janë evidentuar përgjatë vlerësimit të fletëve të votimit për subjektet zgjedhore.



Data: 28.04.2021

Nr. 216

Për disiplinimin e procesit të numërimit të fletëve të votimit për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore

3. Grupet e numërimit nxjerrin rezultatin vetëm për fletët e votimit në të cilat është votuar qartësisht për kandidatin e subjektit zgjedhor. Fletët e votimit të cilat kanë më shumë se një përzgjedhje nuk përlogariten në tabelën përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për deputetë.
4. KQZ do të hetojë administrativisht çdo parregullsi të kryer nga grupet e numërimit të votave duke përfshirë edhe verifikimin nga pamjet filmike. Grupet e numërimit mbajnë përgjegjësi për çdo vlerësim në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.14/2021 të KQZ-së.
5. Ngarkohen KZAZ-të dhe Grupet e Numërimit për zbatimin e këtij urdhri.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

